REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Roskovec , më 01.07.2022

Nr. 640/prot

VENDIM

NR 40 .DATË 29.06.2022

"PËR
"PJESMARRJEN E BASHKISË ROSKOVEC, NË SUBJEKTE ME KOMPETENCA TË PËRBASHKËTA ME QËLLIM KRYERJEN E SHËRBIMEVE TË FURNIZIMIT ME UJË DHE TË LARGIMIT, TRAJTIMIT DHE PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA"

Në mbështetje të nenit 113, të Kushtetutës, të Nenit 9, dhe të pikës 1 dhe 5, të Nenit 14 e vijues të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", të ndryshuar, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar,te VKM nr.302, datë 11.05.2022 "Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujrave të ndotura",Këshilli i Bashkisë;

VENDOSI :

1. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë, në përputhje me Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore", për të negociuar me bashkitë e Qarkut dhe/ose bashkitë nga qarqe të tjera në afersi gjeografike si dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, për mundësinë lidhjen e marrëveshjes specifike për krijimin e Subjektit të Kompetencave të Përbashkëta, për kryerjen e veprimtarisë së furnizimit me ujë, largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura në zonat e shërbimit.

2. Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë në cilësinë e tij si Aksionar i vetëm i Shoqërisë "Sh.A Ujësjellës Kanalizime Roskovec", që pas krijimit të Subjekteve me Kompetenca të Përbashkëta ku Bashkia do të jetë aksionare, të vijojë me miratimin në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionareve të autorizimit për Administratorin e Shoqërisë Aksionare "Sh.A Ujësjellës Kanalizime Roskovec"për nënshkrimin e çdo akti të nevojshëm kontraktorë dhe noterial me qellim të transferimit të veprimtarisë ekonomike për tek shoqëria e re SKP-UK që do të krijohet.

3. Ngarkohet Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike me zbatimin e këtij vendimi.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Kadri Hyska

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA ROSKOVEC